



Organization for Security and Co-operation in Europe
MISSION IN KOSOVO

BOJKOTI NË NIVELIN KOMUNAL

Përmbledhje

Më 26 tetor 2002, populli i Kosovës doli në zgjedhje për të dytën herë pas konfliktit për të zgjedhur kuvendet komunale. Zgjedhjet komunale përafërsisht 1.2 million votues të zgjedhur të Kosovës me zotësi juridike u ofruan rastin për të shprehur mendimet e tyre për punën e kuvendeve gjer tani. Në 17 komuna partitë që zotëronin shumicën gjatë mandatit të mëparshëm prap fituan shumicën e votave. Në 13 komuna forca opozitare kishte fituar shumicën e vendeve. Ky tranzicion nuk ka shkuar qetë në të gjitha komunat. Gjashtë muaj pasi u mbajtën zgjedhjet e kuvendeve komunale ende vazhdojnë me bllokadën politike: anëtarët e kuvendit vazhdojnë më parë të mos marrin pjesë, ose të bojkotojnë kuvendin dhe mbledhjet e komiteteve.

Arsyet kryesore për këtë bojkot dallojnë në gjithë Kosovën dhe mund të përmbledhet në disa modele të përgjithshme: (i) rezufimi për të pranuar rezultatet e zgjedhjeve. (ii) mospajtimi me shpërndarjen e vendeve përbrenda komuniteteve; (iii) mosmarrja në konsideratë e mendimit të opozitës; (iv) lojaliteti ndaj subjekteve partiake dhe instruksioneve të tyre nga niveli qëndror; (v) pakënaqësia me procesin e zgjedhjes së shërbimit civil. Në të gjitha këto raste, atmosfera politike në kuvendet komunale ka mbetur e ndarë, me përfaqësuesit e subjekteve partiake pa dëshirë për të negociuar dhe ndërtuar koalicion për t'i përballur probleme së bashku.

Rezultatet e bojkotit të këtij mentaliteti janë serioze. Kur nuk mund të arrihet kuorumi¹, projektet e komunës bllokohen dhe pengohen mjetet e shërbimit. Bojkoti gjithashtu çon në mungesë të transparencës, pasi që sistemi i verifikimit dhe balancimit nuk mund të funksionojë, kurse pjesëmarrësit janë të privuar nga përfaqësimi efektive. Partitë që bojkotojnë mund të konstatojnë se vendimet në nivelin lokal janë marrë pa ata. Në fund është e dëmshme për interesat e bojkotuesve kur kjo bëhet e përhershme.

Në nivelin lokal, zgjedhjet konstruktive për qeverisjen lokale nevojiten të marrin një qasje, të koordinuar me përqendrim në njerëz. Partitë politike duhet të fillojnë të përgjigjen për nevojat e popullit. Ky proces gjithsesi duhet të fillojë në nivelin lokal.

¹ Rregullorja nr.200/45 për vetëqeverisjen në Kosovë –paragrafi 14.1:Kvorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendeve komunale dhe të komiteteve kërkon gjysmën e anëtarëve të emëruar që të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhje.

Informacion i përgjithshëm.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 siguron vetëqeverisjen e komunave në Kosovë sipas standardeve të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje. Rregullorja gjithashtu përfshin edhe pushtetin dhe përgjegjësitë të transferuara në nivelin komunal. Mirëpo, raportet e OSBE-së vazhdimisht theksojnë se lloji i autonomisë lokale të paraparë në letër dhe me frymën e këtyre dokumenteve ende nuk është realitet. Ky dokument kohëve të fundit fokusohet në praktikën e përgjithshme në mes anëtarëve të emëruar të kuvendit komunal në bojkotimin e punës së kuvendit ose të komiteteve të tij si një rrugë e lehtë për të protestuar. Ky problem ka qenë evident në dhjetë komunat vijuese:

Deçan
Kaçanik
Kamenicë
Klinë
Lipjan

Malishevë
Novoberdë
Suharekë
Viti
Shtërpçë

Shembujt të identifikuar- arsyet kryesore për bojkot.

Në secilën prej këtyre dhjetë komunave bllokada politike është shfaqur pasi që anëtarët e kuvendit kanë vazhduar të përcaktohen që ose të mos marrin pjesë ose të bojkotojnë mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve. Arsyet kryesore për bojkotim dallojnë në gjithë Kosovën por mund të përmbledhen në disa modele të përgjithshme:

1) Refuzimi për të pranuar rezultatet e zgjedhjeve.

Refuzimi për të pranuar rezultatet e zgjedhjeve dhe për tu përfshirë në procesin politik më parë si palë ose si parti qeverisëse është evidentuar në gjithë Kosovën.

Në **Lipjan, Kaçanik** dhe **Kamenicë**, partitë që kishin humbur i kanë lëshuar mbledhjet e kuvendit pas rundit të parë ose të dytë të zgjedhjeve për kryetar dhe nënkryetar të komunës kur është bërë e qartë se kandidatët e tyre nuk do të arrijnë për të fituar asnjërin prej këtyre posteve. Ky është demonstrim i moskuptimit të procedurave dhe institucioneve demokratike dhe rolin e njerëzve të zgjedhur në këto organe.

Në **Novoberdë**, pushteti politik ndërroi pasi që entitetet partiake të sërbeve të Kosovës formuan koalicion duke u dhënë 10 vende prej 17 vendeve të mundshme në zgjedhjet komunale të fundit. Për anëtarët e PDK-së ka qenë e pamundur të pranojnë fitoren e koalicionit të Sërbeve dhe kanë vazhduar të mosbashkëpunojnë me kryetarin dhe nënkryetarin e KK të sërbeve të Kosovës që prej zgjedhjeve. Në mënyrë të veçantë ata kanë refuzuar të japin betimin ose të marrin pjesë në sesionet e KK gjatë gjashtë muajve ,derisa kjo parti e kuptoi këtë, katër vendet e saj do të humbeshin nëse anëtarët e caktuar nuk do të marrin vendet e tyre.⁸

² Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/11 për zgjedhjet komunale në Kosovë seksioni 7.3 i jep kompetencë Përfaqësuesit Special të sekretarit gjeneral për të përfunduar mandatin dhe kërkoj nga komisioni qëndror zgjedhor për të siguruar zëvendësimin .”Përfundimi “ është vendim formalishtë i shpallur përmes së cilës personi

2) Mospajtimi me shpërndarjen e vendeve në komitete midis partive politike,

posaçërisht brenda tre komiteteve të obligueshme –për politikë dhe financa,për bashkësi dhe për ndërmjetësim ndonëse emërimet janë të rregulluara rreptësisht⁹.

Në **Lipjan**,ndarja e vendeve ka sjelluë tension në mes partive politike.Si LDK-ja edhe entitetet⁴ e bashkuara të sërbeve të Kosovës kanë bojkotuar ose lëshuar mbledhjet e kuvendit komunal dhe/ose të komiteteve për shkak të mospajtit për përbërjen e tyre. Kthimi në mbledhje është kushtëzuar me shtimin e numrit të anëtarëve në komitete.Si rezultat i kësaj komiteti për Politikë dhe Financa është i vetmi organ politik që funksionon në komunë.

3)Mos marrja parasysh e pikëpamjeve të opozitës.

Në **Viti**, LDK-ja zotëron shumicën absolute nuk e ndien të nevojshme që të konsultojë ose të ndëgjojë opozitën e PDK-së e cila ende bojkoton tërë punën e komisioneve.Me 29 prill situata u rëndua pasi që PDK-ja ,Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Iniciativa Qytetare e Vitisë (IQV) lëshuan mbledhjen e KK-së nga frika se Kuvendi funksionon në mënyrë jodemokratike. Këtu çështja e grindjes ka qenë mosgatishmëria e kryetarit të KK-së që të kërkojë nga ish Kryeshefi ekzekutiv i cili tani është nënkryetar i KK-së që të paraqesë në raport që ai kurrë nuk e ka bërë.Opozita ka thënë se nuk do të kthehet deri sa të paraqitet raporti kurse ish KE-ja ka refuzuar të paraqesë atë.

Problem i ngjajshëm është paraqitur në **Kamenicë** ,ku PDK-ja dhe AAK-ja kanë bojkotuar punën e komiteteve dhe të KK-së si protestë kundër qëndrimit të LDK-së.shumicë.Me vetëm shumicën në Kuvend (14 prej 31 vendeve), LDK-sëka vota të mjaftueshme për të qeverisur vetë.Sidoqoftë kuorumi i domosdoshëm (16 prej 31) mund të arrihet kur të paraqiten përfaqësuesit e sërbeve të Kosovës.Me 15 prill është mbajtur mbledhja me iniciativën e kryetarit të KK-së nnga radhët e LDK-së në të cilën kanë marrë pjesë dy anëtarë të PDK-së dhe dy anëtarë të AAK-së si dhe përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut -(UNMR)¹⁰, zëvendësi i tij ,KFOR-I dhe OSBE-ja.Qëllimi i mbledhjes që të arrihet një marreveshje politike dhe të përfundojë bojkoti i PDK-së dhe AAK-së nuk është u arritur por mbledhja ka ofruar nje shansë partive politike që të bisedojne për arsyet e tyre për moskënaqësi dhe bojkot.

U pajtuan që të takohen prap për diskutime të mëtejshme.Megjithatë pas disa mbledhjeve LDK-ja dhe AAK-ja më në fund arritën një marrëveshje.Qëndrimi autoritar i kryetarit të LDK-së duket se mbetet shqetësimi kryesor i anëtarëve të PDK-së .

Kështu është rasti gjithashtu edhe në **Lipjan** ku 13 anëtarët e LDK-së kanë refuzuar të marrin pjesë në mbledhjet e KK –së pasi që e konsiderojnë vetveten të kenë qenë të mospërfillur nga PDK-ja për formimin e koalicionit me partitë e tjera. Disa sesione jane anuluar si rezultat i bojkotit.Këta anëtarë janë takuar për herë të parë në m0ars të vitit 2003 tre muaj pasi që janë zgjedhur.Gati të gjithë anëtarët ishintë pranishëm në atë kohë, por edhe njëherë të cekim se ata nuk mundën të marin asnje

që më parë ishte anëtarë nuk do të jetë më.. Kjo mund të përfshijë krejt prej vdekjes,deri burgu,dorëheqja dhe mosarritja për të kryer betimin me kohë.

³Modeli i statutit komunal – Pjesa VI për institucionet politike komunale Artikulli 40 : (...) Anëtar i secilit komitduhet të caktohet nga kuvendi komunal sipas rregullorës (...).

⁴ KP Koalicioni I kthimit dhe DSS Partia Demokratike e Sërbisë

⁵Që nga 1 Prilli 2003 titulli “administratori regional “ dhe “administratori komunal “ respektivishtjanë zëvendësuar me “përfaqësuesi regjional i UNMIK-ut “dhe” përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut”.

vendim meqë kuvendit i mungonte kuorumi sepse disa anëtarë kanë lëshuar mbledhjen. Me 28 prill Komiteti për Politikë dhe Financa ka shtruar çështjen se dega e bashkuar e LDK-së nuk i zbatonte vendimet.

4) Lojaliteti ndaj entiteteve partiake dhe instrukcionet e tyre nga niveli qendror.

Për shkak të centralizimit të strukturave partiake degët komunale të partive politike shpesh veprojnë sipas direktivave të nivelit qendror. Kjo shkakton probleme në **Lipjan**, ku rezultatet e çertifikuara të zgjedhjeve nuk i kanë sjellur shumicën e vendeve asnjërës parti dhe nuk është formuar asnjë koalicion. Si pasojë e kësaj, Kuvendi nuk është në gjendje të marrë vendime. Në Lipjan Partia Demokratike e Ashkalive (PDAK) ka marrë një vend dhe ka refuzuar të marrë pjesë në nivel të gjerë, por jo veçanërisht për shkak të direktivave nga niveli qendror partiak. Në këtë rast vetëm një votë e vetme mund të luajë rol kyç që Kuvendi të formojë qeverinë dhe të fillojnë punën. Kjo është mundësi e rrallë rasti që është humbur kur një parti të vogël t'i ofrohet mundësia të ketë ndikim të madh në procesin lokal politik.⁶

5) Pakënaqësi me procesin për zgjedhje të nëpunësve civilë

Shërbimet civile komunale përbëhen nga kryeshefi ekzekutiv, bordi i drejtorëve dhe personeli i administratës. Nga të gjithë këta njerëz është kërkuar që të jenë lojalë ndaj institucioneve të qeverisjes së përkohshme pa druajtje ose anim dhe pavarësisht nga pikëpamjet politike ose përkatësisë. Që të sigurohet kjo, ligji¹² i zbatueshëm në Kosovë ka parashikuar që panelet e përzgjedhjes së pavarur të emëruar nga ana e KK-së, t'i paraqesin e rekomandimet Kuvendit Komunal për emërimin e kryeshefave ekzekutivë dhe të drejtorëve brenda Bordit Komunal.

Përbërja e komisioneve për rekrutimin e panelit të kryeshefitë ekzekutiv dhe procedurën ligjore për ndërprerjen ose vazhdimin e pozitës së drejtorëve nuk është çështje politike. Sidoqoftë në praktikë është parë që partitë politike presin që këto panele të përbëhen me drejtësi që shpesh do të thotë përbërje sipas pikëpamjeve të tyre politike. Pas emërimeve rizgjedhja ose përjashtimi duhet të bëhen rreptësisht sipas rregullorës së UNMIK-ut.⁸ Ri-shpallja e rasteve pas kontratës⁹ trevjeçare duhet të ndodhë vetëm nëse nuk janë plotësuar detyrat e punës dhe kjo jo për arsye politike. Liderët partiakë

⁶ Gjithashty duhet vërejtur se mospjesëmarrja absolute e anëtarëve të PDAK-së në asnjë aktivitet mund të interpretohet si protest kundër presionit nga ta gjatë muajve të fundit nga fusha e ndryshme.

⁷ Fondi ligjor për Shërbimet Civile në Kosovë është e pajisur me:

- Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2000/45 për vetëqeverisje të komunave në Kosovë – Seksioni 30.8, 31.4, 52.
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/36 në Kosovë për Shërbimet civile – Seksioni 3 në lidhje me kushtet e punësimit Seksioni 12 Rishikimi i caktimit në nivelin drejtues të departamentit
- Direktivat administrative Nr.2003/2 që plotësojnë rregullorën e UNMIK-ut Nr.2001/36 në Shërbimet Civile në Kosovë – Kapitulli II për punësim dhe kapitulli IX në mbarimin e punësimit .
- Modeli I statutit të Kosovës dhe rregullat e procedurave – Pjesa VIII në Shërbimet Civile Komunale

⁸ Në lidhje me largimin e drejtorëve rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, Seksioni 30.8 dhe 31.4 konstaton që të dy edhe kryeshefi ekzekutiv dhe drejtorët e departamentit state that both the CEO and departmental directors “*may only be dismissed by the Municipal Assembly and only on the grounds that he or she has failed to properly carry out his or her responsibilities or the post is no longer needed.*” Additionally, Section 52 states that “*The elections constitute no cause for reconsidering appointments.*”

⁹ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 në shërbimin civil të Kosovës, Seksioni 3.3: “Kontratat e punësimit në shërbimet civile duhet të jenë për periudha deri në tre vite, dhe mund të vazhdohet.”

UNMIK Regulation No.2001/36 on the Kosovo Civil Service, Section 3.3: “*Contracts of employment in the Civil service shall be for a period of up to three years, and may be extended.*”

nuk munden automatikishtë dhe njëanshëm të emërojnë kandidatët ose intervistuesit P.sh. në panelin për përzgjedhjen e kandidatit pas skadimit të kontratës.

Përmbushja e detyrave dhe profesionalizmi duhet të jenë kriteret e vetme të zbatueshme për shërbimet civile komunale. Ndarja politike nuk duhet të merret parasysh në procesin e punësimit. Ky parim i përgjithshëm i qeverisjes së mirë i detyrueshëm me me Rregulloret e UNMIK-ut. Por fakti që shërbimi civil është paraparë të jetë apolitik dhe organ profesional duket se ka mbetur i parëndësishëm për politikanët në përpjekjet e tyre për të fituarpozita udhëheqëse për anëtarët partiakë të tyre. Në shumicën e komunave ende ka një numër të nëpunësve civilë të cilët mbajnë pozita të larta partiake, edhe këto dy raste përputhen sipas ligjit në fuqi¹⁰. Drejtorët e komunave, p.sh normalisht nuk do të jepin dorëheqje nga pozitat e tyre partiake.

Ky politizim i rekrutimit të nëpunësve civil në komuna është dëshmuar si një katalizator tjetër për mosfunksionimin e kuvendit komunal.

Në **Kaçanik**, ngecja aktuale politike buron nga një garë politike që ka të bëjë me përzgjedhjen e ShE-ve. Ish ShE-ja (anëtar i PDK-së) ishte rizgjedhur në bazë të një marveshjeje midis PDK-së dhe AAK-së, që kjo pozitë t'i takonte AAK-së. Kjo shkaktoi dobësimin e raporteve të koalicionit PDK/AAK. Dorëheqja e mëvonshme e një anëtari të LDK-së i mundësoi PDK-së të formojë një kuorum në mënyrë të pavarur. Deri sa të arrihet një marrëveshje politike mbi emërimin e ShE-së, AAK-ja dhe LDK-ja nuk do të marrin pjesë në asnjë mbledhje të Kuvendit Komunal. Lufta për pushtet politik vazhdon të shkaktojë përçarje në qeverisjen lokale.

I njëjti problem ekziston edhe në **Kamenicë**, me dominim të LDK-së ku në procesin e rekrutimit të drejtorëve gjë të cilën PDK-ja e sheh si zgjatje të paligjshme të kontratës së ShE-së. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit, PDK-ja, në të vërtetë, është kërcënuar se nuk do të kthehet më nëse këto kontrata nuk anulohen. Megjithatë, në një mbledhje të jashtëzakonshme e cila u mbajt më 7 maj, AAK-ja e përfundoi bojkotimin e vet pas arritjes së një marrëveshjeje me LDK-në mbi përbërjen e panelit për rekrutimin e drejtorëve.

Madje edhe në **Shtërpçë**, ku ende dominon një model i mirë i bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve sërbë dhe shqiptarë të Kosovës, klima ende nuk është e përshtatshme, posaçërisht sa i përket politizimit të procesit të rekrutimit për postet e Bordit të Drejtorëve. Duket se momentalisht nuk ekziston asnjë vullnet për dialog konstruktiv për arritjen e kompromisit, kurse rreziku që subjektet politike shqiptare të Kosovës të bojkotojnë për shkak të kësaj çështjeje është shumë prezent. OSBE-ja, në bashkëpunim me UNMR-në vazhdojnë të angazhohen për dialog në mënyrë që të gjendet një zgjidhje. Dorëheqja e Kryetarit të KK-së, që është bërë më 13 maj, e cila është pranuar shumë mirë dhe respektuar nga të gjitha palët, nuk duket se do ta përmirësojë situatën.

Një stagnim i ngjashëm është prezent edhe në **Klinë**, me shpalljen e vendeve të lira të ShE-ve dhe të Bordit të Drejtorëve dhe me emërimin e panelit për rishikimin e këtyre posteve. Disa shpjegime dhe këshilla ligjore lidhur me këtë çështje janë dhënë nga OSBE-ja dhe UNMR-ja për zgjidhjen e kësaj ngecjeje përmes bashkëpunimit e jo konfrontimeve. Edhe pse PDK-ja dhe AAK-ja morën pjesë në procesin e votimit për shpalljen e sërishme të vendeve të lira për drejtorë, vetëm disa anëtarë nga radhët e këtyrë partive politike kanë votuar. Në mbledhjen e Kuvendit Komunal që është mbajtur më 10 maj, prej tetë emërimeve është emëruar vetëm një person për postin e drejtorit, me

¹⁰ Rregullorja Nr. 2001/36 në Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë – Seksioni 4: Shërbyesit civil kanë të drejtën të takojnë partive politike dhe organizatave tjera politike por duhet që të shmangen nga kyja active në aktivitet politik.- Ose shiko Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2 –Seksioni 28-1.

pjesmarrjen e të gjitha partive në votim. PDK-ja e lëshoi mbledhjen në shenjë proteste ndaj emërimit të kandidatëve për drejtor, shumica e të cilëve janë nga LDK-ja, duke u bazuar në kriteret e përkatësisë politike, kurse AAK-ja protestoi ndaj përbërjes së panelit i cili i vlerësonte kandidatët. Në **Suharekë**, gjithashtu, PDK-ja është duke i tërhequr anëtarët e vet nga të gjitha komisionet, për shkak të qëndrimit të shumicës së partive (LDK), posaçërisht supozohet se është duke u zhvilluar njëanshmëri politike në të gjitha nivelet e rekrutimit për shërbimin civil.

Pasoja të bojkotimit në qeverisjen komunale dhe për popullin e Kosovës.

Subjektet politike që vendosin t'i bojkotojnë strukturat lokale nuk mund t'i përfaqësojnë apo t'i artikulojnë interesat e partisë apo të komuniteteve të tyre dhe në përgjithësi e rrezikojnë qeverisjen komunale.

Objektivi i vetëm që arrihet me qëndrime të tilla është dhënia e deklaratave. Bojkotimi mund të mbetet mjet i fuqishëm vetëm nëse pjesëmarrësit e tij janë mjaft fleksibilë dhe premtojnë vazhdimisht që do të përfundojnë bojkotimin si dhe rrjetin e komunikimit. Lëshimi i mbledhjes së Kuvendit Komunal, si shenjë proteste, paraqet mungesë të qasjes konstruktive drejt pjesëmarrjes demokratike në qeverisjen lokale. Kjo shpeshherë krijon pasoja vijuese:

1. Pasoja të dëmshme për interesat e popullatës vendore:

Çdo synim i qëllimshëm i cili bllokoi procesin e demokratizimit në Kuvendin Komunal dhe në komisionet e kuvendit, në fund të fundit, nuk i mbështet interesat e popullit. Shumë anëtarë të kuvendit e konsiderojnë veten si delegatë të partisë politike ndaj të cilës janë përgjegjës e jo si përfaqësues të drejtpërdrejtë të elektoratit të tyre. Por në kuadër të komunave, pëmbajtja e udhëzimeve të nivelit qendror- të cilat përfshijnë bojkotimin dhe mosbashkëpunimin- rrezikojnë interesat e popullit dhe nuk lënë asnjë mundësi për ndonjë zgjidhje më të mirë.

Bojkotimi shumë shpesh rrezikon interesat e shoqërisë lokale lidhur me zhvillimin e mëtejshëm dhe demokracinë, për shkak se:

- ***Çështjet e vendorëve nuk zgjidhen.*** Bojkotimi ykonishtë nënkupton humbjen e kuorumit dhe shtyrjen e mbledhjes për shkak të mungesës së pjesëmarrjes. Gjithashtu nënkupton vështirësimin dhe vonimin e punës së ardhshme të kuvendit. Si rezultat, shkaktohet ngecje e punës në tërësi të kuvendit. Kjo gjithashtu shkakton edhe moszgjidhjen e problemeve të tjera. Bojkotimi në të vërtetë e pengon kuvendin komunal të vazhdojë të punojë më tutje lidhur me çështjet konkrete, të cilat duhet të shqyrtohen në nivelin lokal.

- ***E tërë puna e kuvendit mund të kompromitet.*** Puna e përgjithshme e qeverisjes komunale do të pësojë nëse komisionet nuk janë formuar por edhe nëse ata që janë emëruar nuk e kryejnë punën e tyre si duhet. Puna paraprake e komisioneve është me rëndësi për punën efikase të vetë Kuvendit Komunal. Pra, kur anëtarët e kuvendit vijnë të papërgatitur në mbledhje, shpesh prezentohen fjalime të papërqëndruara, të stërzgjatura dhe të përsëritura.

Pas kësaj kur komisionet që kanë mandat nuk janë në gjendje t'i mbajnë funksionet e tyre, interesat kolektive të elektoratit kompromitohen. Një rast konkret lidhur me këtë ka ndodhur në mes të muajit prill të vitit 2003, në **Lipjan**, ku një donator i ka tërhequr fondet e dedikuara për projektin, për shkak të paaftësisë së autoriteteve komunale për të arritur vendimin kolektiv të mbi projektin e shkollës fillore. Negociatat për këtë projekt kanë vazhduar me muaj të tërë dhe deri më 23 prill

2003 Kuvendi Komunal është dashur të caktojë trollin për këtë projekt dhe të pajtohet lidhur me lokacionin. Fillimisht, qëllimi ka qenë të ndërtohet një shkollë fillore për fëmijët e komunitetit serb të Kosovës. Pas negociatave të shumta midis palëve të involvuara dhe pas këshillave të ofruara nga UNMR-ja, është ndryshuar plani për ndërtimin e “shkollës” në të cilën, në vitin e parë të themelimit të saj, do të shkollohen vetëm fëmijët serbë të Kosovës, kurse në vitin e dytë aty do të shkollohen edhe fëmijët shqiptarë të Kosovës. Akoma dy partitë më të mëdha të Kosovës - PDK dhe LDK- nuk pajtohen me këtë projekt. Me këtë shembull praktik, kuvendi tregoi që, në kuadër të tij, interesat e partive janë mbi interesat e komuniteteve, ku si rezultat paraqitet edhe humbja e fondeve që do të shfrytëzoheshin për të mirë të popullatës vendore.

2. Mungesa e transparencës.

Bojkotimi fillimisht pengon sistemin e kontrollimeve dhe balancimeve, të rëndësishme në çdo demokraci: pala në opozitë nuk mund të ushtrojë funksionin e mbikëqyrjes në kuadër të komunës, siç do të duhej të vepronte. Bojkotimi i subjekteve politike në mënyrë konstruktive duhet të sfidojë politikën e shumicës përmes propozimeve dhe kritikave konstruktive. Ata duhet të sigurojnë që vendimet dhe veprimet e kuvendit të merren në mënyrë transparente, e jo t'i injorojnë përgjegjësitë e tyre ndaj shoqërisë lokale duke mos bërë gjë dhe dobësuar institucionet në të cilat janë zgjedhur për të punuar.

Veç kësaj, duke mos marrë pjesë në Kuvend, anëtarët e zgjedhur e provojnë veten nga e drejta për të monitoruar punën e ekzekutivit me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet plenare dhe të këshillave. Kz problemi rrjedh nga fakti se njerëzit nuk e shfrytëzojnë shpesh këtë mundësi. Megjithatë kishte disa kundërshtime për shkak se anëtarëve të publikut nuk u lejua hyrja, mirëpo kjo ndodhi për shkak të mungesës së informatave lidhur me kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes.

3. Përshtypjet negative në interes të bojkotuesve sidomos kur bojkoti bëhet i përhershëm

Kundërshtimi për të marrë pjesë në punën e Kuvendit Komunal mund të sjellë disa efekte pozitive afatshkurte, siç janë tërheqja e vëmendjes në këtë çështje. Megjithatë në afat më të gjatë ka ndikim negativ si në interesin e bojkotuesve ashtu edhe në komunën në përgjithësi.

Nëse qëllimi i bojkotit ishte arritja e ndryshimeve ai nganjëherë mund të duket i arsyeshëm. Por shumë shpesh ky lloj i kundërvënies së heshtur “mund të tregohet negativ, nëse secili aktor dëshiron të mbajë pozitën e vet. Veç kësaj, disa gjëra mund të zgjidhen edhe pa pjesëmarrjen e bojkotuesve, me rezultate që do të ishin më të mira sipas tyre, nëse do të merrnin pjesë dhe ndikonin në debat. Me fjalë të tjera bojkoti dhe bllokada politike janë antiproduktive për këto përgjegjësi. Mospjesëmarrja në mbledhjet e komiteteve d.m.th. se vendimet mund të merren pa marrë parasysh pozitën e njerëzve që mungojnë. Kur të ketë kourum. Sado që të jetë arsyeja e vlefshme për të protestuar në fund, bojkoti del se është joefektiv. Kështu shantazhimi i formës së tillë do të ishte mirë të kryhej në favor të mjeteve të tjera më efektive të opozitës.

4. Pasojat ligjore

Sipas rregullorës¹¹ anëtari i cili ngel për të përcjellë ndonjë mbledhje të Kuvendit Komunal ose të Komiteteve për gjashtë muaj në vijim ndalohej të jetë anëtarë dhe si pasojë e kësaj humb pozitën e vet si një përfaqësues i zgjidhur. Kështu që vetëm anëtari i PDAK-së i Kuvendit Komunal në Lipjan rrezikon të humb vendin në Kuvend. Nëse nuk merrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit para 26 majit ai do të përmbush gjashtë muaj të mos pjesëmarrjes.

Përmirësimi i arritur pas përfundimit të bojkotit

Efekte pozitive janë dëshmuar kur bllokada politike ka përfunduar. Në **Malishevë**, stagnimi tremujorsh përfundoi në një sesion të Kuvendit me 10 mars. Pavarësisht nga lëshimi i zakonshëm i mbledhjes nga anëtarët e LDK-së si shenjë e pakënaqësisë në lidhje me përbërjen “jo të drejtë” të panelit dhe ndarjen e vendeve brenda Komitetit për Politikë dhe Financa kuorumi u arritë pasi që gati të gjithë anëtarët e PDK-së ishin present në atë kohë. Si shenjë e kompromisit me LDK-në është marrë vesh që të rritet numri i vendeve në Komitetin për Politikë dhe Financa. Por disa probleme ende priten pasi që LDK-ja ka lajmëruar që nuk do të merr pjesë në Komitetin e Komiteteve.

Në **Novobërdë** si LDK-ja ashtu edhe PDK-ja kanë bojkotuar Kuvendin e doiminuar nga serbët. Bojkoti i LDK-së mbaroi kur udhëheqësit ishin në gjendje të marrin një vendim dhe të tregojnë gatishmëri që të punojnë përbrenda këtij sistemi në dobi të komunës. PDK-ja¹² më në fund vendosi që t'i marrë katër vendet e fituara në zgjedhjet lokale të teorit të vitit 2000, pas një bojkoti gjashtëmujor, pra në fillim të muajit maj 2003. Këta, tre nga katër anëtarë të PDK-së të certifikuar kanë dhënë betimin para Përfaqësuesit Komunal të Kombeve të Bashkuara më 9 maj dhe pastaj morën pjesë në punimet e Kuvendit Komunal, kurse i katërti nuk e ka bërë këtë për shkaqe personale. Dega e PDK-së ka thënë që e ka “rishikuar strategjinë e vet” nga pikëpamjet e faktit se nuk do të kishte më shumë kandidatë të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm se nëse këta të fundit nuk do të jepnin betimin kurse vendet e PDK-së do të humbnin. Është edhe një kandidat tjetër në listën e partisë i cili mundë ta marrë vendin e katërt në KK pas certifikimit të tij.

Një shembull tjetër në **Shtime** ku shumica e vendeve është nga PDK-ja, në fillim u mendua që bashkëqeverisjes do t'i vinte fundi. Pas humbjes së një pjese të rëndësishme të votave nga rivali i tyre në zgjedhjet e vitit 2002, përfaqësuesit lokal të LDK-së dolën nga Kuvendi derisa kryetari dhe nënkryetari ishin duke u zgjedhur. Vendimi është marrë, gjoja duke u bazuar në konsultime me nivelin qendror të LDK-së në Prishtinë. Kur më në fund LDK-ja i pranoi rezultatet e certifikuar të zgjedhjeve dhe pranoi përbërjen e komitetetve duke u bazuar në Rregulloren 2000/45 të UNMIK-ut, pjesëmarrja e tyre ka siguruar që negociatat me PDK-në të jenë konstruktive.

Në **Deçan** situata politike ka qenë e tensionuar për shkak të procesit të përygjedhjes të nëpunësve civilë. Anëtarët e LDK-së nuk kanë qenë kooperativë me koalicionin AAK/PDK dhe kanë dalur nga sesioni i vlerësimit të Bordit të Drejtorëve në shkurt të vitit 2003, përkundër këshillave që janë bërë nga OSBE-ja dhe përfaqësuesi i UNMIK-ut. Mirëpo në mbledhjen e Kuvendit më 31 mars, LDK-ja

¹¹ Rregullorja Nr. 2000/45 – Seksioni 20.3: nëse ndonjë anëtarë I Asamblesë Komunale dështon në ndjekjen e mbledhjeve të Asamblesë Komunale në periudhë prej gjashtë muajsh ai duhet të pushojë punën derisa të mos japë arsyetim të aprovuar nga Asambleja Komunale.

¹² Do të jetë në kujtesë se në fillim të muajit Nëntor 2002 PDK ka pasur në plan bllokadën e rrugëve, ngujimin e tyre para ndërtesave të Komunave që të pamundësojë funksionimin e UNMIK-ut dhe komunës dhe që të pengojnë pjesëmarrjen e antarëve të zgjedhur Serbe të Kosovës hyrjen në ndërtesën e komunës.

mori pjesë dhe qe aktive .Në diskutimet mbi çështjet komunale brenda Kuvendit që atëherë kanë shkruar përpara.

Konkluzion

- **Së pari, natyra e bojkotimit të punës së kuvendeve komunale është e rrezikshme për jetën politike në Kosovë si dhe për procesin e demokratizimit të shoqërisë.**

Duhet të theksohet se asnjë sistem politik nuk mund të funksionojë si duhet nëse politikanët janë të gatshëm të marrin pjesë në kuvende komunale vetëm nëse fitojnë. **Politikanët kosovarë duhet t'u tregojnë votuesve të tyre se ata vërtet dinë si të negociojnë dhe të arrijnë kompromis.** Këto janë shkathtësi të cilat i nevojiten një shoqërie demokratike, e jo ultimatumet apo bojkotimet. Gjithashtu ekzistojnë edhe shkathtësitë për funksionimin e një shoqërie të pas luftës, të cilat mund të tregojnë progres vetëm nëse të gjitha segmentet janë të gatshme për bisedime të ndërsjella për gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

Rekomandime:

*Politikanët në nivelin lokal duhet të punojnë në mënyrë konstruktive që të bëhen shembull për qëndrimet demokratike duke u angazhuar për zhvillimin e dialogut ndërpartiak dhe ndëretnik në komunë. **Dialogu dhe bashkëpunimi është një strategji afatëgjate e dëshmuar për tejkalimin e ngecjes politike.** Kjo qasje përfshin si vijon:*

*- **Gatishmëria për diskutim.** Në një shoqëri demokratike, çështjet zgjidhen përmes debateve. Një dialog konstruktiv për gjetjen e kompromisit gjithmonë krijon mundësi më të mira për ndryshime pozitive.*

*- **Përshtatja dhe angazhimi për arritjen e një qëllimi të përbashkët në nivelin lokal.** Për të qenë të suksesshëm, bisedimet duhet të fokusohen në qëllime të përbashkëta dhe qasje të përbashkët të problemit, duke filluar që nga ato më kryesoret deri te çështjet jokundërshtuese. Kjo është mënyra më e mirë për oponentët politikë t'u shmangen diferencave dhe të punojnë së bashku.*

- **Së dyti, kur përfaqësuesit politikë vendosin të bojkotojnë, ata humbin rastin për prezentimin e interesave të votuesve të vet.**

Qeverisja lokale duhet t'i ofrojë shërbime të mira popullatës lokale. Shumë shpesh është vështirësuar puna e qeverisjes lokale apo është bërë e pamundur me prezencën e bojkotit. **Qeverisje me përgjegjësi konsidorihet ajo çka kërkojnë votuesit, kurse kjo është ajo çka ata janë në gjendje të pranojnë.** Përfaqësuesit e zgjedhur janë përgjegjës ndaj votuesve, të cilët ua kanë dhënë besimin atyre, t'i paraqesin pikpamjet, nevojat dhe brengat e tyre (të votuesve).

Rekomandime:

*- **Politikanët vendorë duhet gjithmonë të kenë parasysh se është përgjegjësi e tyre t'i shërbejnë popullit dhe t'ua përmirësojnë jetën e votuesve të tyre.** Kjo do të mund t'u ndihmojë atyre t'i realizojnë disa ndryshime të vërteta në nivelin lokal.*

***Zgjidhjet konstruktive për qeverisje të mirë mund të arrihen nëpërmjet qasjes së koordinuar të njerëzve, e cila fokusohet në nevojat e popullit.** Kjo nënkupton lëvizjen prej një qasje të vogël politike deri në një politikë të orientuar në rezultate, duke u bazuar në ofrimin e shërbimeve publike. Debatet ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur duhet të përqëndrohen në një angazhimin të vërtetë të zhvillimit lokal si një çështje urgjente.*

*- **Përveç kësaj, votuesit lokalë dhe shoqëria civile duhet të reagojnë dhe të bëjnë presion mbi përfaqësuesit e tyre për pjesmarrje e jo për bojkot, nëse dëshirojnë t'i zgjidhin problemet e komuniteteve.** Këtë mund ta arrijnë vetëm me pjesëmarrje aktive në takime publike apo me*

prezentimin e peticioneve pranë kuvendit komunal.¹³ Anëtarët e kuvendeve komunale do të ishte mirë t'i ndryshojnë qëndrimet e veta dhe të kenë një qasje pjesëmarrëse dhe pajtuese, nëse shohin se përkrahësit e tyre reagojnë në sjelljet e tyre.

- Mediat janë të obliguara ta informojnë popullatën lidhur me pasojat dhe efektin e bojkotit të asambleve komunale në jetën e tyre të përditshme. Mediat lokale janë rruga më efektive nga e cila popullata lokale mund të informohet lidhur me çështjet dhe me punën e komunës së tyre. Mediat, gjithashtu mund t'i artikulojnë nevojat e qytetarëve ndaj KK-së, duke thënë se këto bojkote nuk i zgjidhin nevojat e tyre.

- **E treta, politikanët duhet të jenë të vetëdijshëm se ka papajtueshmëri në strukturat hierarkike partiake lidhur me konceptin e vetëqeverisjes lokale.**

Përfaqësuesit e zgjedhur në kuvende shumë shpesh e shohin veten si organe të partive të veta politike. Ose së paku, ata janë shumë të influencuar nga kultura dominante e partive politike e cila i kufizon liritë e tyre për marrjen e vendimeve të pavarura, duke u bazuar në njohjen e rrethanave në atë lokacion. Në të shumtën e rasteve, kjo rezulton me polarizimin e pozitive në KK, si dhe anëtarët e zgjedhur preferojnë t'i përcjellin linjat e përgjithshme partiake, në vend që t'i adaptojnë ato me nevojat dhe rrethanat lokale.

Vetëqeverisja lokale kërkon më shumë se vetëm të punohet si organ i nivelit më të lartë. Puna e përfaqësuesve të zgjedhur duhet të përqendrohet në të qenit kreativ për përgjigje ndaj nevojave të vërteta. Pikënisja për përgjegjësi dhe për një sistem funksional të kontrollit dhe të bilancit është reforma e partive politike. Një vetëqeverisje kuptimplotë mund të zhvillohet vetëm në korelacion me autonomi kuptimplota të degëve të partive politike dhe me antarët individualë. Në të kundërtën, institucionet e vetëqeverisjes do të mbesin si farsë e një sistemi vërtetë të centralizuar.

Rekomandime:

- Partitë politike duhet ta përmirësojnë strukturën e brendshme që të jetë më demokratike. Degët e partive politike mund vetëm të punojnë për prezentimin e interesave lokale të anëtarëve partiakë nëse ata u përgjigjen këtyre partive politike. Kjo mund të arrihet vetëm nëse statuset e partive sigurojnë që vendimet për kandidatët lokalë në listat e kandidatëve për komuna të bëhen në nivelin lokal e jo në nivelin qendror të partisë..

- Gjithashtu, partitë politike duhet t'i inkurajojnë antarët e tyre të zgjedhur për pjesmarrje në kuvendet komunale dhe për një punë konstruktive me partnerët lokalë. Përfaqësuesit të cilët arrijnë të japin disa rezultate në komunat e tyre kanë përparësi që të marrin më shumë vota për partinë në të ardhmen, në krahasim me ata që nuk kanë dhënë rezultate të mira dhe të cilët nuk kanë punuar mirë.

- Rregullat e zgjedhjeve¹⁴ sipas së cilës vendi (i asmblesë) i takon individit të zgjedhur e jo partisë së cilës ai/ajo i takon nuk duhet të ndryshohet. Kjo siguron që përfaqësuesi i zgjedhur të mos mund të zëvendësohet kur ata vendosin të marrin pozicion të pavarur nga vendimi i nivelit qendror. Kjo pavarësi është esenciale që t'ua bëjë të mundshëm përfaqësuesve të zgjedhur për shërbimet e interesave lokale.

¹³ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 në vetëqeverisjen lokale në Kosovë, seksioni 8 në Takimet Publike dhe peticionet. Gjithashtu shiqo Model Statusin Komunal, kaptina 2 mbi takimet publike, kaptina 3 në konsultime tjera publike, kaptina 4 peticionet

¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2002/11 në Zgjedhjet Komunale në Kosovë, Seksioni 7.2.

Shtojcë

Numri i vendeve të partive politike në Kuvendin Komunal

<u>Komuna</u>	<u>Numri i vendeve sipas partisë politike</u>	<u>Totali i vendeve</u>
Prishtinë/Prishtina	LDK (29), PDK (13), AAK (4), PD (1), PReK (1), KDTP (1), DSS (1), KP (1)	51
Podujevë/Podujevo	LDK (25), PDK (12), AAK (2), PD (1), BK (1)	41
Prizren/Prizren	LDK (16), PDK (12), KDTP (4), VATAN (2), AAK (2), PShDK (1), BSDAK (1), PD (1), DPP (1), KP (1)	41
Suharekë/Suva Reka	LDK (26), PDK (10), AAK (2), LPK (2), PReK (1)	41
Gjakovë/ Gjakovica	LDK (17), AAK (10), PShDK (5), PDK (3), UD Gj (3), IRDK (2), PLK (1)	41
Pejë/Pe	LDK (19), AAK (12), PDK (4), PShDK (1), Vatan (1), KP (1), IRDK (1), BDIKHB (1), Independent Candidate (1)	41
Mitrovicë/Mitrovica	LDK (23), PDK (15), AAK (2), PD (1)	41
Gjilan/Gnjilane	LDK (23), PDK (13), AAK (2), KP (1), OSA (1), DSS (1)	41
Ferizaj/Uroševac	LDK (24), PDK (12), AAK (2), DSS (1), PDAK (1), PshDK (1)	41
Malishevë/Mališevo	PDK (17), LDK (13), AAK (1)	31
Glogovc/Glogovac	PDK (26), LDK (4), BK (1)	31
Lipjan/Lipljan	PDK (14), LDK (13), AAK (1), PDAK (1), DSS (1), KP (1)	31
Rahovec/Orahovac	LDK (15), PDK (10), AAK (3), LPK (1), PD (1), KP (1)	31
Deçan/De çani	LDK(15), AAK (15), PDK (1)	31
Istog/Istok	LDK (18), PDK (6), AAK (3), PShDK (1), Vatan (1), KP (1), IRDK (1)	31
Klinë /Klina	LDK (13), PDK (10), AAK (4), PShDK (3), KP (1)	31
Skenderaj/Srbica	PDK (26), LDK (4), PReK (1)	31
Vushtrri/ Vu itrn	LDK (18), PDK (10), AAK (2), PD (1)	31
Kaçanik/Ka anik	PDK (15), LDK (14), AAK (2)	31
Kamenicë/Kamenica	LDK (14), PDK (9), AAK (4), KP (2), DSS (1), KOS (1)	31
Viti/Vitina	LDK (17), PDK (9), AAK (2), PShDK (1), IQV (1), KP (1)	31
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	LDK (12), PDK (5), PDAK (1), KP (1), AAK (1), IQFK (1)	21

Obiliq/Obili	LDK (11), PDK (6), PD (1), PKM (1), OSPS (1), KP (1)	21
Shtime/Štimlje	PDK (12), LDK (9)	21
Dragash/Dragaš	LDK (8), PDK (6), Vatan (3), GIG (2), AAK (1), LPK (1)	21
Leposavi /Leposaviq	DSS (5), SNV (3), Citizens' Initiative of Leposavic Socialists (3), KP (2), SPO (1), GIPP (1), GIZ (1), Independent Candidate (1)	17
Zubin Potok/Zubin Potok	DSS (8), GISK (4), GIK (1), "SURVIVAL" Zubin Potok (1), KP (1), PDK (1), LDK (1)	17
Zvečan/Zveçan	SNV (6), DSS (5), KP (2), SPO (2), SD (2)	17
Novobërdë/Novo Brdo	KP (4), DZZ (3), DSS (2), KOS (1), PDK (4), LDK (3)	17
Štrpce/Shtërpçë	SDP (3), SSZ (3), DSS (2), PKM (1), SPO (1), KP (2), PDK (2), LDK (2), KOS (1)	17